



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2019:190986

Datë: 11.03.2021

Numri i dokumentit: 01588825

**P.nr.3/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale në rigjykim kundër të pandehurit M. M. nga Vushtrria rr.”J. T.” nr...., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 në lidhje me par.6 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm (2019:0044796) PP.II.nr.2144/19 e datës 01.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 09.03.2021, në praninë e Prokurores së shtetit Stojanka Kasalloviq, të pandehurit M. M., përfaqësuesit të palës së dëmtuar KEDS me autorizim Genc Hasani, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 09.03.2021, me datë 11.03.2021, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I PANDEHURI: M. M.**, nga i ati Xh., e ëma F. i lindur me datë ..., me numër personal ..., me vendbanim në Vushtrri, rr. “J. T.”, nr..., ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i pa punë, i martuar, prind i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

### ËSHTË FAJTOR

**SEPSE:** Në periudhën e pa përcaktuar e deri më 10.02.2018, në Vushtrri në rrugën “B Kuqi”, me qëllim që ti sjell vetes përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e dinë se janë në dispozicion vetëm në këmbim të pagesës dhe iu është shmangur pagesës, në atë mënyre që e ka furnizuar objektin e vet më rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar, pasi që i njëjti ka refuzuar që KEDS-it t’ia japë njehsorin elektrik, pasi që punëtoret e KEDS-it te njëjtin e kanë larguar dhe kanë vendosur njehsorin e ri digjital, me çka, me leximin mekanik të numrave do te vërtetohet sasia e rrymës së shpenzuar dhe ashtu energjia e shpenzuar në lokal nuk ka qenë e regjistruar dhe në këtë mënyrë e ka dëmtuar KEDS-in.

- **Me këtë ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 në lidhje me par.6 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 37, 38, 39, 40, 43, 46, 48, 69, 70, dhe nenit 314 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 e 463 të KPPK-së, e

## **G J Y K O N**

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind euro (500 €), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë euro (50 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur (2019:0044796) PP.II.nr.2144/19 e datës 01.08.2019, kundër të pandehurit M. M. nga Vushtrri, rr.“J. T.”, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 në lidhje me par.6 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka pranuar këtë lëndë pas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.305/20, të datës 09.12.2020 përmes të cilit aktvendim është aprovuar ankesa e të pandehurit dhe lënda është kthyer në rigjykim. Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimin të lëndës ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.02.2021, në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Pas fjalës hyrëse të palëve, prokurorja e shtetit ka kërkuar nga gjykata që seanca të shtyhet për një date tjetër, me qëllim të plotësimit të aktakuzës sa i përket dispozitivit të saj. Seanca e vazhdimin të shqyrtimit gjyqësor u mbajti me date 09.02.2021, në të cilën kanë qenë prezent i pandehuri, Prokurorja e Shtetit Stojanka Kasaloviq, përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS-it me autorizim G. H. si dhe dy punëtorët e KEDS-it, dëshmitarët B. Sh. dhe A. R. të cilët janë marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarëve. Në këtë seancë prokurorja e shtetit ka bërë precizimin e aktakuzës dhe atë dispozitivin e aktakuzës.

### **Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Prokurorja e shtetit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.12.2019, se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni

314 par.1 në lidhje me par.6 të KPRK-së, pasi që i njëjti ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizim nga ana e furnizuesit të autorizuar, fajësia e të akuzuarit do të vërtetohet me dëgjimin e dëshmitareve që kanë bërë kontrollë në vendin e ngjarjes, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dhënë me datën 27.01.2020, duke shtuar edhe precizimin e aktakuzës që e bëra sot, duke deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës së ngritur kundër të pandehurit për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 në lidhje me par.6 të KPRK-së, ku me provat e administruara është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin të shqiptoj dënim sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS, në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 17.12.2019, ku ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se i pandehuri nuk e ka prezantuar një sorin elektrik nëpërmes të cilit është furnizuar me energji elektrike me qëllim të shmangies të pagesës së energjisë së shpenzuar elektrike apo asgjësimit të provave bindëse të keqpërdorimit të një sorit, kjo do të vërtetohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjithashtu ka bërë kërkesë pasurore juridike për dëmin e shkaktuar në vlerë prej 1,315.96 euro. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me datën 21.01.2020, me te vetmin plotësim se e për krahi precizimin e plotësimit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, duke deklaruar se e mbështetë fjalën e Prokurores së Shtetit dhe njëherit nga administrimi i provave materiale si dhe dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, po ashtu theksoj se konsumatori është njoftuar dy herë nga Kompania KEDS për pasojat e mos dorëzimit të orës – një sorit ku i njëjti e ka obligim ta dorëzoj. Si palë e dëmtuar kërkojmë kompensimin e dëmit të shkaktuar në shumë prej 1,315.96 euro siç është përcaktuar në aktakuzë.

I pandehuri në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse të dhënë në seancën e datës 17.12.2019, në të cilën ka deklaruar se e kundërshtoj aktakuzën për faktin se një sorin në asnjë moment nuk ka qenë i kyçur në mënyrë të kundërligjshme, një sorin i vjetër ka qenë i instaluar më herët në një kontejner 12 m<sup>2</sup>, për këtë kam edhe dëshmitë e pagesave që janë bërë vazhdimisht si dhe listën e pagesave për secilin muaj dhe atë para një sorit të ri dhe fotot të cilat tregojnë se cilat mjete janë të kyçura. Pastaj është ndërtuar një objekt i ri dhe ky objekt normalisht se ka shpenzime më të mëdha sepse është 800 m<sup>2</sup>, dhe KEDS është bazuar në këtë objekt në raport me dëmin e shkaktuar, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ndien veten plotësisht të pafajshëm dhe do të marr të gjitha veprimet derisa të vërtetohet se unë jam i pafajshëm, dhe këto janë vetëm supozime të KEDS – it të cilat nuk paraqesin prova në raport me gjykatën. Po ashtu, i shtoj edhe këtë pjesë kur është bërë ndërrimi i orës në kontenier prej 12 m<sup>2</sup>, është dashur të evidentohen edhe pajisjet që kanë qenë aty, në rastin konkret kanë qenë dy poqa elektrik. Pas 6 muajve, deri në 1 (një) vit, kur është ndërtuar objekti dhe kur është lëshuar me qira, me sipërfaqe prej 800 m<sup>2</sup>, punëtorët e KEDS-it kanë ardhur dhe i kanë evidentuar pajisjet, të cilat kanë qenë në këtë hapësirë dhe në bazë të evidentimit të pajisjeve kanë bërë kalkulimin e rikthimit të humbjeve, e cila është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe dua të theksoj se vendi nuk ka mbetur asnjë minutë pa orë elektrike dhe unë asnjëherë nuk kam ndërhy në një sorin. Mos dorëzimi i orës nuk është bërë sepse unë kam qenë aty dhe kompania e cila e ka ndërtuar objektin e ka marrë një sorin tim me gjithë kontejner.

## **Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor**

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

### **Provat personale**

- Dëgjimin e dëshmitarit A. R. punëtor tek e dëmtuara KEDS, i lindur më 01.03.1986 nga fshati Druar/Vushtrri me numër të letërnjoftimit 1172624843, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.12.2019, ka deklaruar se me datë 10.02.2018 ka qenë tek i pandehuri për ndërrimin e njësorit mekanik në atë digjital. I njëjti ka deklaruar se, ndërrimin e njehsorëve e bëjmë kur kërkohet nga udhëheqësi dhe palën e kemi njoftuar se çdo njësor që ndërrohet duhet dorëzohet, me qëllim që të dërgohet në Prishtinë për kalibrim, mirëpo, pala nuk e dorëzoi të vjetrin, me arsye se e ka blerë vetë këtë. Ndonjë mënyrë tjetër për matjen e shpenzimeve të harxhuara nuk ka. Njëtori ka qenë pa bllombë distributive, gjë që e kemi evidentuar në pjesën e djathtë të procesverbalit përkatësisht te numri i Lombës është evidentuar se ska plombë dhe derisa pala nuk na ka dorëzuar njehsorin, ne nuk kemi pasur qasje në objekt, njehsori ka qenë i vendosur në shtyllë dhe aty e kemi ndërruar. Në momentin e ndërrimit të njehsorit ka qenë i pranishëm njëri prej anëtarëve të familjes dhe i njëjti na e ka treguar edhe numrin e letërnjoftimit, të cilin e kemi vendosur në procesverbal.

- Dëgjimin e dëshmitarit B. Sh. - punëtor tek e dëmtuara KEDS, i lindur më 18.11.1975 nga fshati Vidishiq/Mitrovicë me numër të letërnjoftimit 1020859560, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.12.2019, ka deklaruar se me datë 10.02.2018 ka qenë pjesë e ekipit për ndërrimin dhe heqjen e njësorit elektrik, të cilin plan e kemi pasur nga kompania – KEDS për ndërrimin e orëve mekanike në ato digjitale për shkak të leximit më të lehtë në raport me të gjithë konsumatorët, e kemi ndërruar orën por se çka ka ndodhur me të vjetrën nuk jam në dijeni, ora që ka qenë e vendosur në shtyllë nuk ka qenë e bllambur. Njehsori nuk ka qenë i dëmtuar por bllombë nuk ka pasur. Në atë kohë ne nuk kemi bërë fotografi, por, zakonisht i evidentojmë përmes procesit, por, tani në momentin kur hasim ndonjë parregullsi po e fotografojmë.

- Dëgjimin e dëshmitarit I. F., i cili është propozuar nga ana e Prokurores së Shtetit në kuadër të procedurës për plotësimin e provave - menaxher në sektorin për korrigjim dhe rikthimin e humbjeve tek e dëmtuar KEDS, i lindur me ... nga P. lagjja “K. e T.” adresa rr. “E. H.”, nr.19, me numër të letërnjoftimit ..., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor të datës 27.01.2020, ka deklaruar se kalkulimet e rikthimit të humbjeve i bëjmë në përputhje me procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pasi që kemi të bëjmë me rastin konkret me konsumator komercial, kalkulimi është bërë në përputhje me nenin

15 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dt.21.07.2009 e aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për energji elektrike, e cila procedurë parasheh që kalkulimi i rikthimit të humbjeve të bëhet në bazë të pajisjeve në rastin konkret konsumatorit komercial të cilat pajisje janë evidentuar në procesverbalin numër 2455013 të dt. 06.10.2018. Në rastin konkret kalkulimi i rikthimit të humbjeve është bërë në bazë të pajisjeve të evidentuara si në procesverbalin e lartë shënuar, ku në nenin 15.2 i Procedurës llogaritja e fuqisë maksimale bëhet në bazë të kësaj dispozite ka rezultuar  $P_{max}$  në vlerë prej 3.713kË. Po ashtu në bazë të nenit 15.3 të kësaj procedure vlera e  $P_{max}$  shumëzohet me numrin e orëve të punës e që në bazë të procesverbalit të kontrollës të dt. 06.10.2018 orari ka qenë nga ora 8h deri në ora 22h, duke pas parasysh vlerën e fuqisë maksimale të  $P_{max}$  duke shumëzuar me orarin e punës në rastin konkret 14 orë duke e shumëzuar edhe me 22 ditë pune ka rezultuar se konsumatori në bazë të pajisjeve që ka poseduar harxhimi mujor duhet të jetë 1.144 kWh nga vlera e kilovat orëve të kalkuluar prej 1.144 kWh kemi zbritur energjinë mesatare mujore të faturuar në llogarinë e konsumatorit e cila ka qenë 51kËh kjo diferencë 1.144kWh -51 kWh = paraqet energjinë e humbur e cila nuk është faturuar përmes njësorit dhe kjo paraqet energji elektrike të shpenzuar por e pa regjistruar. Vlera prej 1.093 kWh shumëzohet me çmimin për energji për konsumatorin përkatës e që në rastin konkret është 9.29 cent duke shumëzuar me 1.093 kWh rezulton vlera 101.54 euro për një faturë mujore, në bazë të nenit 13 të procedurës së lartë shënuar nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nuk dihet për konsumatorët komercial përvetësohet 12 muaj plus TVSh dhe rezulton me vlerën e dëmit prej 1.315,96 euro, me këtë konfirmoj se kalkulimi i rikthimit të humbjeve është bërë në përputhje të plotë me procedurën e lartë cekur. Konfirmoj se energjia e kalkuluar në vlerë prej 1.315,96 euro është reale dhe e saktë e konfirmon edhe fakti se deri në muajin kur ka qenë në shfrytëzim njëtori i cili nuk është prezantuar nga konsumatori për 6 muajt e fundit është regjistruar energjia mesatare mujore 51kËh, kurse prej ndërrimit të njësorit pra në njësin e ri shihet se nga rrjedha e njësorit se energjia mesatare mujore e regjistruar dhe e faturuar është mbi 1.300 kËh pra kjo diferencë me njësin që nuk prezantohet ka të regjistruar vetëm 51kËh për muaj kurse me njësin e ri ka të regjistruar mesatarisht mbi 1.300kËh për ne është fakt i mjaftueshëm i cili vërteton dëmin e shkaktuar në rastin konkret KEDS –it.

- Marrja në pyetje e të pandehurit M. M., gjatë marrjes në pyetje në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 09.03.2021, ka deklaruar se është pronar i orës më numër DMI – 9023948, po ashtu deklaroi se ora ka qenë e kontrolluar nga KEDS dhe ka qenë e bllobuar, kur është ndërruar ora unë nuk kam qenë prezent dhe për këtë jam njoftuar pas 9 muajve përmes një shkrese, orën nuk e kam dorëzuar sepse kompania që ka qenë e vendosur aty kur është larguar së bashku me kontejnerin e ka marr edhe orën, objekti ka qenë me qira dhe për këtë e kam edhe kontratën, nuk kamë qenë në dijeni për ndërrimin e orës sepse nga muaji Prill kompania ka qenë shfrytëzuese e energjinë dhe ajo është marrë me të. Sa i përket ndryshimit të faturës në muajin vijës pas ndërrimit të njësorit kjo ka ndodhur se unë e kam dhënë në shfrytëzim objektin dhe është rritur shpenzimi i energjisë elektrike. Mua nuk më kujtohet kur është ndërtuar objekti i ri në atë vend ku ka qenë i vendosur njëtori dhe në tërësi e kundërshtoj vlerën e dëmit të caktuar nga KEDS lidhur me këtë çështje penale.

## Provat materiale

- Procesverbalin e përpiluar nga dy punëtorët e KEDS-it me nr.2455013 i datës 06.10.2018, në bazë të procesit më nr.0600301 ku kanë shkuar për verifikim të pajisjeve elektrike dhe kanë konstatuar se konsumatori ka refuzuar nënshkrimin e procesverbalit.

- Procesverbali – raporti për ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, i përpiluar nga punëtorët e KEDS-it B. Sh. dhe A. R. i datës 10.02.2018, në të cilin është konstatuar se është ndërruar njehsori mekanik në atë digjital, njehsori blombohet BCO 1316 dhe pala nuk e prezanton njësorin dhe në pjesën e sipërme të procesverbalit në anën e djathtë është evidentuar se nuk ka Plombë.

- Fatura e datës 29.10.2018 në të cilën është evidentuar dëmi i shkaktuar ndaj palës së dëmtuar KESCo dhe afati i pagesës.

- Fatura për kalkulimi i rikthimit të humbjeve i datës 29.10.2018, e cila është llogaritur në bazë të procesverbalit më nr.0600301, për periudhën kohore 10.02.2018 – 06.10.2018, i përpiluar nga departamenti për konsumator – sektori i rikthimit të humbjeve.

## **Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet**

### **Faktet jokontestuese**

- Është fakt jo kontestues se me datën 10.02.2018, në “B. T.” në të cilën pronar është M. M. është bërë ndërrimi i orës – njehsorit elektrik nga punëtorët e KEDS-it.

- Është fakt jo kontestues se njehsori i energjisë elektrike i vendosur në depon “B. T.” është në emrin e të pandehurit M. Xh. M.

- Është fakt jo kontestues se i pandehuri nuk e ka dorëzuar njësorin elektrik.

- Është fakt jo kontestues se me rastin e ndërrimit të njehsorit nuk janë bërë fotografi,

Faktet e lartcekura nuk janë kontestuar nga palët. Përveç kësaj faktet vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

### **Faktet kontestuese**

- Është fakt kontestues se i i pandehuri i ka shkaktuar dëm në shumën prej 1,315.96 euro palës së dëmtuar KEDS.

- Është fakt kontestues se njehsori nuk ka pasur bllobë distributive,

Këto fakte janë kontestuar nga ana e të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse, me rastin e marrjes në pyetje të pandehurit dhe në fjalën përfundimtare.

## Vlerësimi i Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dsipozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Deklaratës së dëshmitarit A. R., me të cilën vërtetohet se, me datë 10.02.2018 ka qenë tek i pandehuri për ndërrimin e njësorit mekanik në atë digjital., ndërrimin e njehsorëve e bëjmë kur kërkohet nga udhëheqësi dhe palën e kemi njoftuar se çdo njësor që ndërrohet duhet dorëzohet, me qëllim që të dërgohet në Prishtinë për kalibrim, mirëpo, pala nuk e dorëzoi të vjetrin, me arsye se e ka blerë vetë këtë. Ndonjë mënyrë tjetër për matjen e shpenzimeve të harxhuara nuk ka. Njëtori ka qenë pa bllombë distributive, gjë që e kemi evidentuar në pjesën e djathtë të procesverbalit përkatësisht te numri i pombës është evidentuar se ska plombë dhe derisa pala nuk na ka dorëzuar njëhësorin, ne nuk kemi pasur qasje në objekt, njëhësori ka qenë i vendosur në shtyllë dhe aty e kemi ndërruar. Në momentin e ndërrimit te njëhësorit ka qenë i pranishëm njëri prej anëtarëve te familjes dhe i njëjti na e ka treguar edhe numrin e letërnjoftimit, të cilin e kemi vendosur në procesverbal.

- Deklaratës së dëshmitarit B. Sh. me të cilën vërtetohet se, me datë 10.02.2018 ka qenë pjesë e ekipit për ndërrimin dhe heqjen e njësorit elektrik, të cilin plan e kemi pasur nga kompania – KEDS për ndërrimin e orëve mekanike në ato digjitale për shkak të leximit më të lehtë në raport me të gjithë konsumatorët, ora që ka qenë e vendosur në shtyllë nuk ka qenë e bllambur. Njëhësori nuk ka qenë i dëmtuar por bllombë nuk ka pasur.

- Deklaratës së dëshmitarit I. F., me të cilën vërtetohet, se kalkulimet e rikthimit të humbjeve i bëjmë në përputhje me procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pasi që kemi të bëjmë me rastin konkret me konsumator komercial, kalkulimi është bërë në përputhje me nenin 15 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dt.21.07.2009 e aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për energji elektrike, e cila procedurë parasheh që kalkulimi i rikthimit të humbjeve të bëhet në bazë të pajisjeve në rastin konkret konsumatorit komercial të cilat pajisje janë evidentuar në procesverbalin numër 2455013 të dt. 06.10.2018. Në rastin konkret kalkulimi i rikthimit të humbjeve është bërë në bazë të pajisjeve të evidentuara si në procesverbalin e lartë shënuar, ku në nenin 15.2 i Procedurës llogaritja e fuqisë maksimale bëhet në bazë të kësaj dispozite ka rezultuar  $P_{max}$  në vlerë prej 3.713kË. Po ashtu në bazë të nenit 15.3 të kësaj procedure vlera e  $P_{max}$  shumëzohet me numrin e orëve të punës e që në bazë të procesverbalit të kontrollës të dt. 06.10.2018 orari ka qenë nga ora 8h deri në ora 22h, duke pas parasysh vlerën e fuqisë maksimale të  $P_{max}$  duke shumëzuar me orarin e punës në rastin konkret 14 orë duke e shumëzuar edhe me 22 ditë pune ka rezultuar se konsumatori në bazë të pajisjeve që ka poseduar harxhimi mujor duhet të jetë 1.144 kWh nga vlera e kilovat orëve të kalkuluar prej 1.144 kWh kemi zbritur energjinë mesatare mujore të faturuar në llogarinë e konsumatorit e cila ka qenë 51kËh kjo diferencë 1.144kWh -51 kWh = paraqet energjinë e humbur e cila nuk është faturuar përmes njësorit dhe kjo paraqet energji elektrike të shpenzuar por e pa regjistruar. Vlera prej 1.093 kWh shumëzohet me çmimin për energji për konsumatorin përkatës e që në rastin konkret

është 9.29 cent duke shumëzuar me 1.093 kWh rezulton vlera 101.54 euro për një faturë mujore, në bazë të nenit 13 të procedurës së lartë shënuar nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nuk dihet për konsumatorët komercial përveçohet 12 muaj plus TVSh dhe rezulton me vlerën e dëmit prej 1.315,96 euro, me këtë konfirmoj se kalkulimi i rikthimit të humbjeve është bërë në përputhje të plotë me procedurën e lartë cekur.

Gjykata i vlerësoi dhe ia fali besimin e plotë deklaratave të dëshmitarëve, si deklaratat bindëse, konsistente dhe reale, dhe në pajtim me gjendjen faktike të vërtetuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështje penale, këto deklaratat ishin në pajtim me provat materiale, përfshirë:

- Procesverbalin e përpiluar nga dy punëtorët e KEDS-it me nr.2455013 i datës 06.10.2018, në bazë të procesit më nr.0600301 ku kanë konstatuar se kanë shkuar për verifikim të pajisjeve elektrike dhe kanë konstatuar se konsumatori ka refuzuar nënshkrimin e procesverbalit.

- Procesverbali – raporti për ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, i përpiluar nga punëtorët e KEDS-it B. Sh. dhe A. R. i datës 10.02.2018, në të cilin është konstatuar se është ndërruar njehsori mekanik në atë digjital, njehsori bllobohet BCO 1316 dhe pala nuk e prezanton njësorin dhe në pjesën e sipërme të procesverbalit në anën e djathtë është evidentuar se nuk ka Plombë.

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, Vjedhje e shërbimeve nga nenin 314 par 1 të KPRK-së, pasi që i pandehuri ka siguruar shërbime të energjisë elektrike, duke ju shmangur regjistrimit të rregullt të këtyre shpenzimeve të shkaktuara, duke i shkaktuar dëm të palës së dëmtuar KEDS.

Për gjykatën deklarata e të pandehurit në fjalën hyrëse, me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ishte, kontestuese, jo e plotë, jo bindëse dhe kishte për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale dhe të njëjtës gjykata nuk ja fali besimin.

### **Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje direkte. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar, rrethanat personale pasi që i pandehuri është mbajtës i familjes dhe se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson



se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par. 1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit**

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

### **Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike**

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar KEDS, në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së, për faktin se të dhënat e mbledhur në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurve për gjykimin e plotë e as të pjesshëm për kompensimin e demit, për faktin se evidentimi i pajisjeve elektrike në procesverbalin e 06.10.2018 është bërë pas 8 (tetë) muajve nga data e ndërrimit të njëorit i cili është barë me datë 10.2.2018.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.03/2021, datë: 11.03.2021**

**Procesmbajtësja**  
**Bahrije Smakolli**

**GJYQTARI**  
**Agron Maxhuni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.